



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1144/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Adnan Konushevci dhe Burim Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Strahinja Spasiq, kandidat për Kryetar Komune të Klllokotit, nga radhët e Subjektit politik GI Srpska Narodna Sloga, me seli në Komunën e Klllokotit, paraqitur, kundër subjektit politik Lista Serbe për shkak të shitblerjes së votave, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet i palejuar apeli Anr.1144/2021, i datës 21.11.2021, e paraqitur nga Strahinja Spasiq, kandidat për Kryetar Komune të Klllokotit, nga radhët e Subjektit politik GI Srpska Narodna Sloga, me seli në Klllokot, paraqitur, kundër subjektit politik Lista Serbe me të cilën ka kërkuar që të anulohen votat e kandidatit të listës Srpska Vlladan Bogdanoviq për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021, përkatësisht të anulojë rezultatet përfundimtare të votimit të publikuara nga KQZ-a, dhe të shpallet fituesi i zgjedhjeve lokale në komunën e Klllokotit, kandidati i GI Srpska Narodna Sloga - Strahinja Spasiq.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 21.11.2021, ka pranuar një apel nga Strahinja Spasiq, kandidat për Kryetar Komune të Klllokotit, nga radhët e Subjektit politik GI Srpska Narodna Sloga, me seli në Komunën e Klllokotit me të cilën pretendon se përfaqësuesit e Listës Srpska dhe zyrtarët në siç thekson në sistemin e Republikës së Serbisë (komunave Gjilan dhe Viti) kanë blerë vota për kandidatin Vladana Bogdanoviq te listës serbe në Klllokot. Parashtruesi i apelit në lidhje me Vendimin e PZAP-së Anr 1142/21, kërkon që të kërkohe audio incizimin me dëshminë e

Srgjan Jereniqit, të cilën ia ka dhënë prokurorit kujdestar i Prokurorisë Themelore në Gjilan, ku e njëjta sipas tij është dorëzuar edhe në KQZ.

Parashtruesi i apelit thekson se ankesa e tyre në PZAP është e ligjshme dhe e dorëzuar në afatin e paraparë ligjor, pas publikimit të rezultateve përfundimtare për kryetarë të komunave nga KQZ me datën 20. 11. 2021.

Parashtruesi i apelit edhe një herë kërkon nga PZAP-i që të përcaktojë saktë situatën faktike se në komunën e Killokotit ka pasur kërcënime ndaj votuesve për të votuar kandidatin e Listës Srpska, ku sipas tij ekzistojnë edhe ankesa në PZAP se janë blerë vota për Listën Serbe dhe kandidatin e tyre Vladan Bogdanoviq nga ana e zyrtarëve serbë siç thekson në sistemin serb, Sasha Millosheviq (komuna e Gjilanit) dhe Srgjan Nikoliq (komuna e Vitinës), të cilët gjithashtu ndanë edhe kontratat për dhënien e materialeve ndërtimore në këmbim të votave për kandidatin e Listës Serbe.

Më tej në apel theksohet kandidati i saj për kryetar Vladan Bogdanoviq dhe zyrtarët e saj Sasha Millosheviq dhe Srgjan Nikoliq, kanë shkelur vlerat dhe parimet themelore të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe se rezultati i votimit të Listës Serbe bazohet në shkeljen e Kushtetutës së Kosovës dhe ligjit për zgjedhjet lokale dhe kjo sipas parashtruesit të apelit paraqet vepër penale.

Parashtruesi i apelit thekson se votuesit të cilët kanë votuar me asistencë nuk janë asistuar nga anëtarët e KQZ-së, por asistimi është bërë nga persona të cilët kanë qëndruar në grupe afër qendrave të votimit dhe kanë organizuar votimin për të dëshmuar se kanë votuar për Listën Serbe. Në kerkese theksohet se personat që kanë dëshmuar në PZAP, se kanë ndihmuar dhe votuar për Listën Srpska me kërkesën e Sasha Millosheviq-Belli. Deklaratë që ka asistuar në votim për kandidatin e Listës Srpska ka dhënë edhe Danijel Kojiq. Sekretari i komunës së Vitisë në sistemin serb Vladimir Nojkiq i cili organizoi votimin me asistencë në Vrbovc e detyroi Sreqko Kojiqin të votojë për Listen Srpska dhe Vladan Bogdanoviq.

Parashtruesi i apelit thekson se anëtarët dhe kryesuesit e këshillave zgjedhorë në vendvotime kishin frikë nga hakmarrja e Listës Serbe, dhe nuk kanë mbajtur evidencë për keqpërdorimet gjatë votimeve për ti evidentuar ato në librat në vend votime, ku përfaqësuesi i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje gjatë numërimit ka hasur në fletëvotime të shumta me simbole

të ndryshme ku votimi është bërë me simbole të ndryshme në mënyrë që votuesit të dëshmojnë se kanë votuar kandidatin e Listës Srpska, ndërsa anëtarë të KKZ-së në Klllokot Alban Etemi ka kërkuar që këto të gjetura të evidentohen në librin e evidencave të KQZ-s por një gjë e tillë nuk është bërë. Prandaj parashtruesi i apelit kërkon që të anulohen rezultatet e votimit të kandidatit të Listës Serbe për kryetar të komunës së Klllokotit, Vladan Bogdanoviq, në vendvotimet me numrin: 3703D/01R, 3703D/02R, 3701D/01R, 3701D/02D. sepse sipas tyre ka bazë të mjaftueshme ligjore për të vërtetuar se Lista Serbe i ka siguruar votat për kandidatin për kryetar të komunës së Klllokotit Vladan Bogdanoviq duke blerë vota. Sipas parashtruesit të apelit Sasha Millosheviq kryetar i komunës së Gjilanit dhe Srgjan Nikoliq kryetar i komunës së Vitisë në sistemin e siç thekson të R. Serbisë kanë blerë vota për Vladan Bogdanoviqin dhe kanë shpërndarë të holla në vlerë prej 10.000 dinarë (monedha e Republikës së Serbisë) në këmbim të votimit për kandidatin e Listës Serbe ku sipas parashtruesit të apelit dëshmi për këtë kanë korrespondencën në facebook ku mund të shihet se personave të caktuar ju janë paguar votat me nga 10,000,00 dinar dhe ju është afruar punë nëse votojnë për Listën Serbe. Sipas parashtruesit të apelit theksohet se në raportin e vëzhguesve të Bashkimit Evropian gjithashtu është cekur se Lista Serbe ka blerë vota për Vladan Bogdanoviqin dhe ndërhyrja e institucioneve paralele serbe në ndikimin e rezultateve të votimit të Listës Serbe dhe kandidatit të saj.

Parashtruesi i apelit thekson se pavarësisht arrestimit të anëtarëve të Listës Serbe nga policia e Kosovës në raundin e parë, blerja e votave vazhdoi edhe në raundin e dytë, gjegjësisht ata blenë votat për kandidatin e Listës Serbe, ku Srgjan Nikoliq kryetar i komunës së Klllokotit në sistemin e siç theksohet R. Serbisë ka dhënë kontratë pune djalit të Rade Gjuriqit (Marko Gjuriq) në këmbim që familja e tij ta votojë kandidatin e Listës Serbe, ku si dëshmi është deklarata tij dhe një kopje e kontratës mbi vepër të cilat janë dorëzuar në PZAP.

Parashtruesi i apelit thekson se për të siguruar fitoren dhe kalimin në raundin e dytë javën e fundit para rrethit të dytë të votimit për kryetar të Komunës së Klllokotit, në Mitrovicë të veriut në ambientet e administratës së shkollës në sistemin e siç theksohet të Republikës së Serbisë, janë ftuar të gjithë edukatorët dhe stafi teknik i shkollave të Komunës së Klllokotit me qëllimin për tu bërë presion nën kërcënim e përjashtimit nga puna nëse nuk votojnë për kandidatin e Listës Serbe, ku Ivan Zaprozac, i cili është shef i administratës së shkollave për Kosovën dhe zyrtar i Listës Serbe, ka thirrur mbi 300 persona, mësimdhënës, staf teknik të të

gjitha shkollave në komunën e Klllokotit që marrin paga nga sistemi i Kosovës dhe i Serbisë, duke bërë presion të votojnë për kandidatin e Listës Serbe Vlladan Bogdanoviq.

Parashtruesi i apelit thekson se duke pasur parasysh se ai ka bërë ankesë kundër parregullsisë së zgjedhjeve dhe keqpërdorimeve nga subjekti politik i Listës Serbe në raundin e parë dhe se ankesa është pranuar pjesërisht, ku Lista Serbe është gjobitur, zyrtarët e saj vazhduan si ata në sistemin e Kosovës dhe ata në siç theksohet sistemin e Serbisë në periudhën ndërmjet mbajtjes së rrethit të dytë të zgjedhjeve si dhe në ditën e zgjedhjeve më 14.11.2021, parashtruesi i apelit më tej thekson se njëjtën gjë e kanë bërë edhe drejtoret e shkollave të komunës së Klllokotit në sistemin serb dhe atë të Kosovës Bojana Marinkoviq, Trajan Trajkoviq, Dalibor Dajiq dhe Vlladan Bogdanoviq, i cili është edhe kandidat për kryetar të komunës së Klllokotit, si dhe Goran Marinkoviq, drejtor i departamentit të arsimit në komunën e Klllokotit.

Sipas parashtruesit të apelit presion kanë bërë edhe kryetari i komunës Bozhidar Dejanoviq dhe kryetari i kuvendit Zharko Dejanoviq në zyrtarët e Komunës së Klllokotit, me kërcënimin se nëse nuk e votojnë Listën Serbe do të largohen nga puna, ku Bozhidar Dejanoviq në cilësinë e kryetarit të Komunës së Klllokotit ka dhënë më shumë se 50 kontrata pune në mënyrë për të votuar Listën Serbe ku shumë kontrata pune janë dhënë edhe nga drejtori i shkollës në sistemin serb në këmbim që këta të votojnë për Listën Serbe, pastaj sipas parashtruesit të apelit edhe drejtori i spitalit në Pasjanë, Zoran Periq gjithashtu ka urdhëruar mjekët për tu dhënë pushime mjekësore të rreme për punëtorët e punësuar të shkollës se të njëjtit kinse janë të sëmurë me Covid 19, në mënyrë që në ato vende të punës të punësohen njerëz të rinj dhe në këmbim ata do të votonin për kandidatin e listës Serbe, kontrata të cilat personave të rinj të punësuar iu janë dhënë për një apo dy muaj deri sa zgjat procesi zgjedhorë. Parashtruesi i apelit thekson se kryetari i komunës së Gjilanit në sistemin e siç thekson të R.Serbisë njëherë kryetari i sapo zgjedhur i Novobërdës Sasha Millosheviq-Beli kryetari i komunës së Vitisë Sidjan Nikoliq në sistemin e siç thekson të Republikës së Serbisë në javën e fundit para raundit të dytë të zgjedhjeve për komunën e Klllokotit ftuan votuesit e komunës së Klllokotit në zyrat e tyre dhe shpërndanë zarfe me para në vlerë prej 10.000,00 dinarë për të votuar Listën Serbe, gjithashtu, Srdjan Nikolic, kryetar i komunës së Vitisë në siç thekson në sistemin serb, së bashku me Sasha Mirkoviqin, Zoran Cvetkoviqin, Zvezdan Simiqin dhe Vlasta Bogdanoviqin, ndërmjet dy raundeve të zgjedhjeve ndanë kontrata për ndarjen e materialeve ndërtimore në këmbim të votës për Listën Serbe.

I njëjti thekson se edhe pse kundër katër personave janë ngritur aktakuza për blerje votash nga prokuroria në Gjilan, në rrethin e parë të zgjedhjeve për blerjen e votave, nga anëtarët e Listës Serbe u vazhdua edhe në raundin e dytë për zgjedhjen e kryetarit të komunës, ku sipas informatave të tyre paratë për blerjen e votave i ka siguruar Sasha Millosheviq-Beli dhe i kanë ndarë Bozhidar dhe Zharko Dejanoviq, Goran Marinkoviq, Sasha Mirkoviq, Sasha Marinkoviq, Vladan Bogdanoviq Zoran Cvetkoviq, Radomir Stankoviq, Dalibor Stojanoviq dhe disa persona të tjerë.

Parashtruesi i apelit thekson se të gjithë personat e lartpërmendur që përfaqësojnë siç thekson institucionet e Republikës së Serbisë që veprojnë në Kosovë si dhe institucionet e Kosovës kanë shkelur rëndë të drejtat e qytetarëve në komunën e Kllokotit, kanë shkelur të drejtën e votës së lirë e cila është e garantuar me ligjin për zgjedhjet dhe Kushtetutën e Kosovës, ku sipas parashtruesit të apelit më shumë se 300 personave u është shkelur e drejta e votës së lirë.

Andaj sipas palës ankuese nga të cekurat më lartë, mund të konstatohet se Zgjedhjet Lokale në komunën e Kllokotit, nuk janë mbajtur në një atmosferë të drejtë demokratike siç është e paraparë me ligjin për zgjedhjet e përgjithshme, se ka pasur shumë keq përdorime, manipulime, blerje të votave, shantazhe, kërcënime të votuesve nga ana e përfaqësuesve të Listës Serbe dhe kandidatit Vladan Bogdanoviq.

Prandaj, parashtruesi i apelit kërkonë që PZAP t'i anulojë votat e kandidatit të listës Serbe Vladan Bogdanoviq si të arritura në mënyrë të paligjshme, përkatësisht të anulojë rezultatet përfundimtare të votimit të publikuara nga KQZ-a, dhe të anulohet fitorja e paligjshme në zgjedhjen e kandidatit të Listës Serbe dhe të shpallet fituesi i vërtet i zgjedhjeve lokale në komunën e Kllokotit, kandidati i GI Srpska Narodna Sloga - Strahinja Spasiq. Si dëshmi ka bashkangjitur: publikimin e Info-Plus për presionin ndaj votuesve nga 15.11.2021, ankesat e votuesve që gjenden në PZAP, në mbështetje të ankesës së Anr-së. 1142/21, audio incizimin e Srdjan Jeriniqit, do ta dorëzojmë me e-mail

Paneli pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e apelit gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se apeli i parashtruar nga Strahinja Spasiq, kandidat për Kryetar Komune të Kllokotit, nga radhët e Subjektit politik GI Srpska Narodna Sloga, me seli në Komunën e Kllokotit, ka njëjtësi subjektive, objektive, gjendje të njëjtë faktike me apelin e parashtruar në PZAP, me datën 15.11.2021, kundër subjektit politik Lista Serbe, e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr.1142/2021 të datës 17.11.2021, si dhe me ankesën me numër AA 82/2021 e parashtruar në Gjykatën Supreme me datë 18.11.2021, kundër vendimit të PZAP-it i Anr.1142/2021 të datës 17.11.2021, me cilin Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimet e saja AA 81/2021 i datës 18.11.2021 dhe AA 82/2021 i datës 19.11.2021 i ka refuzuar si të pa bazuara pretendimet e palës ankuese dhe ka vërtetuar vendimin e PZAP-it Anr.1142/2021 të datës 17.11.2021.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton se apeli i parashtruar nga Strahinja Spasiq, kandidat për Kryetar Komune të Kllokotit, nga radhët e Subjektit politik GI Srpska Narodna Sloga, me seli në Komunën e Kllokotit **është çështje e gjykuar “res iudicata”**.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.1142/2021 të datës 17.11.2021, dhe me aktgjykimet e Gjykatës Supreme AA 81/2021 i datës 18.11.2021 dhe AA 82/2021 i datës 19.11.2021 dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimet e lartcekura paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim te pretendimeve konkrete ne kërkesë, përveç faktit se ka vlerësuar ato, se kishte të bënte me subjektin e njëjtë dhe me pretendimet që kanë qenë objekt shqyrtimi nga PZAP sipas vendimeve AA.81 dhe 82/2021, ne të cilat vendime pretendimet e tilla janë trajtuar, andaj paneli pretendimet e ankesës i ka trajtuar për të vlerësuar se a kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, dhe rrjedhimisht rezulton se në vendimet e PZAP, të gjitha pretendimet kanë qenë të parashtruara nga parashtruesi i ankesës, si për sa i përket ndikimit në votues konkretisht në dëshmitarët që theksohen në ankese dhe në dëshmitarët që janë në incizime ku dëgjohen por po ashtu edhe provat konkrete nga të cilat rezulton se janë arrestuar katër persona dhe ndaj tyre ka filluar procedura penale, në këtë kuptim parashtruesi i apelit të gjitha këto rrethana i ka ripërsëritur në ankesën e parashtruar dhe rrjedhimisht për Panelin të gjitha këto pretendime nuk mund të jenë objekt i trajtimit nga PZAP nga fakti se tanimë ka vendim të dyshkallshmërisë saktësisht për këto pretendime të theksuara në ankese, çka nënkupton se kemi edhe vendim gjyqësor të Gjykatës Supreme nga e cila ka trajtuar pretendimet e njëjta kur parashtruesi i ankesës ka ankimuar vendimet e

PZAP-ës. Duke konstatuar këtë gjendje paneli nuk është lëshuar ne vlerësimin e besueshmërisë se pretendimeve te ankese nga këto arsye duke gjetur se kemi te bëjmë me çështje te gjykuar.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e nenit 11.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.1144/2021 më datën 24.11.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.